

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Hungaria ndryshon rregullat e birësimit, hapet rruga për beqarët dhe çiftet e të njëjtës gjini
ADRESA	https://kohajone.com/aktualitet/hungaria-ndryshon-rregullat-e-biresimit-hapet-rruga-per-beqaret-dhe-ciftet-e-te-njejtës-gjini/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 18:12:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 18:11:39 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3b678f4d28a3709d3b72513762fb8bb3c5e6dc4e352065268fbf19b099ebda
TEKSTI	15b2848d03c5bebd4e8fb6d7a21f3e7d0e416cba48319bccf9a5964874a1b8cc
PAMJA	769923bd4d9b179af99fcf686a20492adec74e0c4afecb5661fc955461de0aaf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	166d6525b9aa18a034e998b87d917a28c79a49e2931848ee7cdacc18698ef1c8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	af2eff8ceb96ddd2f94c87aa44001511ffb7ade52559e069c66da2a10eed6fb8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/166d6525b9aa18a034e998b87d917a28c79a49e2931848ee7cdacc18698ef1c8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Hungaria ndryshon rregullat e birësimit, hapet rruga për beqarët dhe çiftet e të njëjtës gjini

AKTUALITET BOTA E DIEL, 13 SHTATOR 2026 20:11



Kryeministri hungarez Péter Magyar ka njoftuar ndryshime të rëndësishme në rregullat e birësimit, duke premtuar një sistem të ri që nuk do të bazohet te statusi martesor apo orientimi seksual i prindërve, por te interesi dhe mirëqenia e fëmijës.

Qeveria hungareze ka publikuar një raport gjithëpërfshirës prej 220 faqesh për mbrojtjen e fëmijëve, i cili arrin në përfundimin se sistemi aktual i birësimit është në prag të kolapsit.



Dokumenti pritët të shërbejë si bazë për rishikimin e plotë të rregullave të birësimit, një proces që ka shkaktuar reagime të forta politike në Hungari, transmeton Telegrafi.



Kryeministri Péter Magyar deklaroi se qeveria e tij do të ndryshojë rregullat që përcaktojnë mundësinë e birësimit nga personat beqarë dhe çiftet e të njëjtës seks, duke argumentuar se sistemi aktual nuk është më i qëndrueshëm.

Sipas tij, vendimi se kush është i përshtatshëm për të birësuar një fëmijë nuk duhet të jetë çështje politike, por duhet t'u lihet profesionistëve, përfshirë psikologët dhe ekspertët e mbrojtjes së fëmijëve.

"Politikanët duhet të tërhiqen një hap pas nga kjo çështje", është shprehur Magyar.

Kryeministri hungarez theksoi se sistemi "nuk mund të funksionojë siç duhet në gjendjen e tij aktuale" dhe se kriteri kryesor duhet të jetë gjithmonë interesi i fëmijës.

Sipas tij, qëllimi duhet të jetë që fëmijët të rriten në një familje të dashur, dhe jo që vendimi të përcaktohet nga orientimi seksual apo statusi martesor i personave që kërkojnë të adoptojnë.

Magyar tha se qeveria tashmë ka nisur punën për ndryshimin e legjisllacionit ekzistues, të miratuar më herët gjatë

LAJMET KRYESORE



Shkëlqim Hajdari nga Bronksi: Drejtësi për çlirimtarët e Kosovës!



Kosova bëhet me Qeveri të re, Kurti zgjidhet kryeministër për herë të katërt



Opinion nga Elvin BLAKAJ: "Jam myslliman" të Ben BLUSHIT e kam lexuar katër herë



Radio "Europa e Lirë": Si po përdoret IA-ja për sigurinë në shkollat e Shqipërisë



I rikthehet sërish pagave të gjyqtarëve, Rama: Marrin 280% më shumë se administrata, gati 2 mijë euro mbi pagën e Presidentit

TË PËRZGJEDHURA



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve



Dëshirat e Spallettit dhe blerjet e Juventus-it



Tesla, drejtimi gjysmë-autonom drejt përshtatjes me rregullat evropiane, thotë Franca



Shpërthen Erion Braçe te Nikoll Lesi në KOHA JONË-DEBAT: Nuk votoj kandidat me "njoftim"!

MË TË LEXUARAT

qeverisjes së Fidesz-it dhe ish-kryeministrit Viktor Orbán.

Sistemi aktual favorizon çiftet e martuara dhe vendos kufizime të mëdha për personat beqarë dhe çiftet e të njëjtit seks.

Reforma e paralajmëruar përbën një kthesë të fortë politike dhe ideologjike nga politikat e ndjekura nga qeveritë e Orbánit gjatë periudhës 2010–2026.

Në dhjetor të vitit 2020, qeveria e Orbánit ndryshoi Ligjin Themelor të Hungarisë dhe ligjin për birësimin, duke përcaktuar në mënyrë të ngushtë konceptin e familjes dhe duke e bërë martesën kriterin kryesor për birësim.

Meqë çiftet e të njëjtit seks nuk lejohen të martohen në Hungari, por mund të lidhin partneritete të regjistruara, më herët një prej partnerëve mund të aplikonte për birësim individualisht.

Një ndryshim ligjor i vitit 2020 e mbylli këtë mundësi. Personat beqarë u detyruan të siguronin një leje të posaçme ministrore për të birësuar, duke e bërë praktikisht jashtëzakonisht të vështirë procesin për anëtarët e komunitetit LGBTQ.

Sipas argumentimit të qeverisë së re, sistemi aktual është i paqëndrueshëm edhe për një arsye tjetër: ndërsa një numër i madh fëmijësh vazhdojnë të jetojnë në kujdesin shtetëror, shumë prindër potencialë të përshtatshëm pengohen nga filtrat politikë dhe procedurat burokratike.

Reforma e re synon të rikthejë një model ku përshtatshmëria e prindërve vlerësohet kryesisht nga profesionistët e fushës.

Magyar argumenton se psikologët dhe ekspertët e mbrojtjes së fëmijëve duhet të kenë rolin kryesor në përcaktimin nëse një familje apo individ është i përshtatshëm për të marrë përsipër rritjen e një fëmije.

Njoftimi ka shkaktuar reagime të forta në mediat hungareze.

Media të lidhura me opozitën e kanë kritikuar nismën, duke akuzuar Magyarin se po "i nënshtrohet lobit LGBTQ", ndërsa mediat e pavarura e kanë paraqitur ndryshimin si një përpjekje për të rikthyer standardet profesionale në sistemin e birësimit.

Ndryshimi vjen disa muaj pasi Partia Tisza fitoi zgjedhjet e prillit me një rezultat dërrmues, duke i dhënë fund 16 viteve të qeverisjes së Fidesz-it.

Pas fitores, organizatat ndërkombëtare dhe hungareze për të drejtat e njeriut kishin kërkuar hapa të menjëhershëm për rikthimin e të drejtave të komunitetit LGBTQ.

Presioni u shtua edhe pas një vendimi të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian, e cila para zgjedhjeve konstatoi se ligji i mëparshëm hungarez për "mbrojtjen e fëmijëve", i kritikuar gjerësisht si diskriminues ndaj personave LGBTQ, shkelte rëndë të drejtën e BE-së.

Me reformën e paralajmëruar, qeveria e re hungareze po sinjalizon një qasje dukshëm më pragmatike ndaj çështjeve sociale, duke synuar që vendimet për birësimin të bazohen te ekspertiza profesionale dhe, mbi të gjitha, te interesi i fëmijës.

MË SHUMË NGA AKTUALITETI



Le Pen nis fushatën për 2027, por tensionet me Bardellan tronditën të...

"Woman Unknown" me regji të kineastes daneze May el-Toukhy, fiton Lua...

Kurti fton PDK-në ta propozojë nënkryetarin: Të mos humbim kohë me pr...



Droni rus godet trenin në kufirin ukrainas-polak! Shpëtojnë mrekullis...



Obama ngre alarmin për inteligjencën artificiale: "Nëse nuk e vëmë në...



Kosova bëhet me Qeveri të re, Kurti zgjidhet kryeministër për herë të...

LAJMET E FUNDIT



Hungaria ndryshon rregullat e birësimit, hapet rruga për beqarët dhe çiftet e të njëjtës gjini

[11 SEKONDA MË PARË](#)



Napoli reagon pas tre humbjeve, Lobotka i jep fitoren Allegrit ndaj Bolognës

[2 MINUTA MË PARË](#)

Le Pen nis fushatën për 2027, por tensionet me Bardellan tronditin të djathtën ekstreme franceze

[10 MINUTA MË PARË](#)

Në protestën e 106-të kundër qeverisë, qytetarët përcjellin mesazhet e tyre edhe përmes pankartave

[13 MINUTA MË PARË](#)

“Woman Unknown” me regji të kineastes daneze May el-Toukhy, fiton Luanin e Artë në Festivalin e Venecias

[25 MINUTA MË PARË](#)

Bayerni fiton me vuajtje ndaj Elversberg, Kane rigjen golin

[27 MINUTA MË PARË](#)

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: **Nikoll LESI**. Adresa e redaksisë: Rruga "Samir Frashëri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA



© 2024 KOHA JONË. All rights reserved.

[PRIVACY POLICY](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.